



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU, TEHNOLOGIJU I INOVACIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY& INNOVATION**

Prishtinë, 05.05.2022

**Përgjigje në pyetjet e OJQ-ve lidhur me thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes
financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore që
mbështesin nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe nxënës të tjerë, që kontribuojnë në
arritjen arsimore**

Pyetje:

Në lidhje me Thirrjen publike që ka lansuar MASHTI për mbështetjen e qendrave mësimore.
Në udhëzime për aplikuesit tek pika:

**1.3 VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTE DHE
SHUMA E PËRGJITHSHME E THIRRJES**

është shkruar:

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të ndahet për çdo projekt individual është
10,000 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 100,000 €. Shuma maksimale për një
qendër mësimore të mbuluar me një projekt është 25,000 €.

Deshëm një sqarim, meqenëse OJQ-ja jonë, që vepron në mbështetje të fëmijëve rom, ashkali
dhe egjiptian zhvillon aktivitete në disa komuna, duam të jemi në përgatitje të projektit jo vetëm
për një Qendër Mësimore, por për disa qendra mësimore në disa komuna të cilat do ta kalojnë
shumën prej 25,000 euro e në mes 100,000 euro!

Pra, jemi të interesuar të dimë si OJQ, a mund të aplikojmë edhe përtej kësaj shume të 25,000
euro!?

Përgjigje:

Nga kushtet e thirrjes publike nënkuptohet se shuma maksimale e një projekti mund të jetë 100.000 euro, ndërsa shuma maksimale për një qendër mësimore – 25.000 euro. Një projekt mund të zbatohet në një ose më shumë qendra mësimore.

Pyetje:

Sa i përket thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore që mbështesin nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe nxënës të tjerë, që kontribuojnë në arritjen arsimore.

Ju lutem nëse keni mundësi të më jepni informacione më në detaje që të më ndihmoni rreth përgatitjes së dokumentacionit.

- A duhet të përgatis një projekt konkret
- A duhet të evidentoj numrin e nxënësve
- A duhet të parashikoj mësimdhënësit.

Përgjigje:

Në thirrjen publike të shpallur nga MASHTI, është i bashkangjitur edhe udhëzuesi për aplikuesit me sqarime, ju lutem referojuni Udhëzuesit.

Pyetje:

Unë jam fitues i një projekti nga Ministria e Arsimit para 2 viteve, a mund të aplikoj edhe në këtë thirrje publike që keni hapur për OJQ-të, apo kjo vlen vetëm për minoritete.

Përgjigje:

Ju lutem lexoni kushtet e thirrjes publike. Nuk mund të japim përgjigje që paragjykojnë përshtatshmërinë e aplikuesve.

Pyetje:

Desha t'ju pyes rreth thirrjes për ofrimin e mbështetjes financiare për qendrat mësimore. A vlen kjo edhe për qendrat e gjuhëve të huaja që ju ofrojnë shërbime pa pagesë të gjithë nxënësve me sindromën down? Nëse po, a keni ndonjë link si mund të aplikoj pasi që, në webfaqe nuk ka?

Përgjigje:

Ju lutem lexoni kushtet që duhet t'i plotësojnë aplikuesit në udhëzuesin përkatës.

Pyetje:

Kam parë një thirrje për grante për komunitetet pakicë.

Jam i interesuar të aplikoj për organizimin e kurseve (trajnimeve) për nxënësit në Komunën tonë pasi këtu nuk kemi një qendër edukative dhe nxënësit e komuniteteve jo shumicë kanë nevojë që të ndjekin mësim shtesë, pasi që performanca e tyre e dobët në arsim dhe braktisja e mësimin në moshë të re është shqetësim për ne.

Do të ju pyesja, projektet individuale a pranohen nga ne apo duhet ne kuadër të një OJQ-je?

Përgjigje:

Thirrja publike është për të ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve që mbështesin dhe promovojnë nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian në qendrat mësimore. Të drejtë aplikimi kanë të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që menaxhojnë qendrat mësimore të cilat janë të regjistruara në MASHTI sipas Udhëzimit administrativ nr. 19/2018 Për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave Mësimore.